**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT**

Nr.10075 prot. Vlorë, më 25.08 2023

**PROJEKT - VENDIM**
**Nr.____, Datë___.___.2023**

**"PËR NJË RISHPERNDARJE TE FONDIT TE SHPENZMEVE TE PARASHIKUAR NË VKB NR.1, DT.18.01.2023 PËR BUXHETIN E BASHKISË VLORË PËR VITIN 2023 I NDRYSHUAR "**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës _____ . _____ . 2023 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlorë, si dhe në diskutimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit, mbështetur në; Ligjin nr,139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, pika 2, neni 9 pika 1.1 b,neni 40 dhe neni 54 pika dh, Ligji nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit", Udhëzimi plotësues nr.2 datë 19.01.2023 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023", V.K.B nr.1 datë 18.01.2023 "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2023.

**VENDOSI:**

1.Te miratoj financimin e K.F.ORIKU me NUIS L36521202N Shoqeri Aksionere me Kaptal 100 % Bashkia Vlorë në formën e subvesionit për shpenzimet për periudhën Shtator - Dhjetor në shumën 5,000,000 lekë .

2. Në buxhetin e Bashkisë Vlorë të vitit 2023 me kod program 1110, të pakësohet fondi prej 5,000,000 lekë, në llogarinë ekonomike 602 në zërin "shpenzime të palanifikuara gjatë vitit 2023" dhe të shtohet në programin me kod 8130 në llogarinë ekonomike 603 subvension në objektin " K.F.Orik me vlerë 5,000,000 leke si me poshtë:

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033421201; Fax 033421201: www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

a) Pakësohen Shpenzimet operative në Programin (1110) Atrikull 602

| G | Titull | Kap | 600 | 601 | 602 | 231 | Shpenzime operative te aparatit te Bashkisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | 1110 | 5 | | | 5,000,000 | | |

b) Shtohet shpenzime operative ne Programin (8130) Artikull 602

| G | Titul | Kap | 600 | 601 | 603 | 231 | Shpenzime operative (subvension ) Per K.F Orik |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | 8130 | 5 | | | 5,000,000 | | |

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkise .

4.Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6

*Konc:* P.Buxhetit
Xhuli Kasëmi

Drejtoria e F.B.K
Hiqmet Haxhaj

Drejtoria Juridike
Sonela Haxhiraj

**KRYETARI**

**Ermal DREDHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**

# RELACION

**MBI PROJEKT-VENDIMIN "PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË SHPENZIMEVE OPERATIVE TË PARASHIKUAR NË VKB NR.1, DT.18.01.2023, PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2023 I NDRYSHUAR "**

**PARA KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-vendimi që po ju paraqesim për miratim per finacimin ne formen e subvensionit per K.F Oriku sh.a per peridhen shtator dhjetor 2023 kerkon te arrije objektivat si me poshte :

K.F Oriku sh.a, me NUIS L36521202N, ka si objekt të aktivitetit të tij organizimin e aktiviteteve sportive të futbollit, krijimin e ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në gara sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit si dhe kryen aktivitete të ndryshme në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë, komunitetit dhe bashkisë.

Qëllimi i K.F Orikut ndër vite ka qenë dhe është krijimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik nga të gjitha moshat të edukimit fizik dhe sportit, e mbështetur kjo nga institucionet e pushtetit qëndror dhe njësitë e qeverisje vendore, Bashkia Vlorë, si dhe nga donatorë të ndryshëm.

K.F Oriku sh.a, ndër vite përfaqësohet nga një ekip zinxhir si dhe nga ekipi i parë që kete vit do te debutoj ne Kampionatin Kombëtarë të Kategorisë së Dytë,Grupi B.

Bazuar në ligjin nr.79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar me ligjin nr.105/2020 datë 29.07.2020, në nenin 7 përcaktohet se Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik. Shteti nxit zhvillimin e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitar, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.

Persa me siper, duke parë që Bashkia Vlorë, në buxhetin e vitit 2023, nuk ka akorduar ,asnjë fond per subvencionim e klubit ne mendojme te financohet ne shumen 5,000,0000 leke .

Kerkesa nga ana e Klubit eshte ne shumen 8,622,920 leke .

Bashkia mundesi reale per financim ka ne shumen 5,000,000 leke ,kurse diferenca prej 3.622,920 leke te financohet nga sponsorat qe ka klubi.

**Kerkesa e Klubit eshte detajuar si me poshte :**

| | Emertimi | Muaji | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Total 10-mujor |
| 1 | Paga punonjesish | 1,010,580 | 1,010,580 | 1,010,580 | 1,010,580 | 4,042,320 |
| 2 | Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 323,150 | 323,150 | 323,150 | 323,150 | 1,292,600 |
| 3 | Trajtim ushqimor | 250,000 | 250,000 | 250,000 | 250,000 | 1,000,000 |
| 4 | Dieta | | 140,000 | 140,000 | 120,000 | 400,000 |
| 5 | Transport | 40,000 | 50,000 | 50,000 | 40,000 | 180,000 |
| 6 | Uniforma | 600,000 | | | | 600,000 |
| 7 | OSHEE | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 60,000 |
| 8 | Internet | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 8,000 |
| 9 | Auditi | | | | | 0 |
| 10 | Security | | 30,000 | 30,000 | 30,000 | 90,000 |
| 11 | FSHF detyrime | | | 300,000 | | 300,000 |
| 12 | Baze materiale sportive | | 60,000 | | | 60,000 |
| 13 | Mirembajtje terrene sportive | | | 50,000 | | 50,000 |
| 14 | Shpenzime te paparashikuara | | | 400,000 | | 400,000 |
| 15 | Shpenz.medikamente mjekesore & analiza | | 50,000 | 40,000 | | 90,000 |
| 16 | Materiale higjeno-sanitare | 50,000 | | | | 50,000 |
| | **TOTAL** | **2,290,730** | **1,930,730** | **2,610,730** | **1,790,730** | **8,622,920** |

Në këto kushte kërkojmë nga ana e Këshillit të Bashkisë ta miratojë këtë Projekt-Vendim, me qëllim për t'i hapur rrugë procedurave të mëtejshme në funksion të realizimit të projektit të sipercituar gjë që do të mundësojë vazhdimsine e klubit te futbollit.

**KRYETARI**

**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË -